



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 168, datë 21.12.2012**

**PËR**  
**MRATIMIN E BUXHETIT TË BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT**  
**PËR VITIN 2013**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.20046, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 42 pika 7 të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe nenit 10 të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së B.SH.S”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e buxhetit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit për vitin 2013, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të B.SH.S, nr. 146, datë 04.12.2012, “Për miratimin e strukturës organizative dhe buxhetin e shpenzimeve administrative të BSHS për vitin 2013”.
2. Ky buxhet duhet të derdhet brenda 30 ditëve kalendarike nga miratimi i këtij vendimi, në përputhje me parashikimet e nenit 7, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, i ndryshuar.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**